



Ungjilli i Thomait

Description

John Dominic Crossan

Fragment i shkëputur nga libri i autorit John Dominic Crossan me titull: "The Birth of Christianity", HarperSan Francisco, New York 1999

Ungjilli i Thomait nuk është, pikë së pari, një nevojë hipotetike (si burimi Q) por një dokument ekzistues i disponueshëm pjesërisht në gjuhën greke (në fragmente nga dorëshkrime të ndryshme) dhe në mënyrë të plotë në gjuhën kopte (si një përkthim i ardhur nga një dorëshkrim i vetëm).

Fragmenti në gjuhën greke është zbuluar nga Grenfell dhe Hunt në 1896-1897 dhe 1903-1904 tek Oxyrhynchus-i i lashtë (1897; 1898; 1904ab). Atë që ata gjetën, ndonëse në atë kohë nuk e dinin se për çfarë bëhej fjalë, ishte një fragment nga Ungjilli i Thomait në origjinalin e tij grek. Më poshtë do përmendim tre papiruset renditur me numra dhe datë sipas katalogut të van Haelst

#593: Papyrus Oxyrhynchus 654 = Ungjilli i Thomait, prologu dhe 1-7

#594: Papyrus Oxyrhynchus 1 = Ungjilli i Thomait 26-33 (me 77b ngjitur 30-së)

#595: Papyrus Oxyrhynchus 655 = Ungjilli i Thomait 24 dhe 36-39

P. Oxy. 654, i cili gjendet në London's British Library, është një fragment i vetëm nga një dorëshkrimi i ripërdorur dhe daton nga gjysma e shekullit të tretë. P. Oxy 1 është një fragment i vetëm nga një kodik dhe daton në fillim të shekullit të tretë, sot gjendet në Oxford's Bodleian Library. P. Oxy. 655 përbëhet nga tetë fragmente nga një papirus dhe daton nga fillimi i shekullit të tretë, sot gjendet në Harvard's Houghton Library. Datimet, normalisht, janë vendosur për kohën kur janë kopjuar dorëshkrimet dhe jo për datën e përpilimit të ungjillit.

Grenfell dhe Hunt dhanë përfundimet vendimtare lidhur me tekstin që përmbahej në këto dorëshkrime. Ato nuk e dinin, normalisht, se ato ishin pjesë e Ungjillit të Thomait, por unë po i sjell këtu përfundimet e tyre për arsye se, sipas gjykimit tim, ato janë të vlefshme dhe të sakta për krejt tekstin e këtij ungjilli. Ato nxorën "katër pika": (1) se kishim të bënim me një pjesë përmbledhjeje thëniesh, të cilat nuk ishin

nxjerrë nga narrativa e ungjijve; (2) se ato nuk ishin përmbajtje e ndonjë teksti heretik; (3) se, në formën e tyre përfundimtare, ato ishin të pavarura nga tekstet e katër ungjijve kanonikë; (4) se ato ishin më të hershme se viti 140 e.r.s. dhe mund ta kishin origjinën edhe në shekullin e parë (1898, 2; shih 1897, 16-20). Duhet theksuar se fragmentet vijnë nga kopje të *ndryshme* të ungjillit të *Thomait*, gjë e cila tregon popullaritetin e lartë të këtij ungjilli (së paku në Egjipt në shekullin e dytë).

Kopja e përkthimit koptik u zbulua në vitin 1945 e.r.s. nga një grup fshatarësh egjiptian të cilët po gërmonin për të gjetur fertilizues prej nitrati në bazë të shkëmbit të Xhebal el-Tarif pranë Nag Mahadit, rreth 250 milje në jug të Oxyrhynchus-it, në bregun perëndimor të Nilit. Ai ishte pjesë e asaj që u njoh më vonë si libraria e Nag Mahadit, dymbëdhjetë kodikë të plotë dhe pjesë të ndryshme nga tridhjetë e dy kodikë të tjerë të cilat gjithsej përmbanin gjithsej pesëdhjetë e dy traktate. Ungjilli i Thomait, p.sh., ishte traktati 2 i kodikut 2, dhe emri nuk i është vënë në prologun e traktatit por veçmas, në fund të tij (Robinson 1979). Ai ruhet në muzeun koptik të Karjos së vjetër (Termi koptik përshkruan gjuhën e vjetër egjiptiane e shkruar me germa greke dhe me disa germa të veçanta shtesë. Por ajo, gjithashtu, përshkruan edhe krishterimin egjiptian, falë lashtësisë së të cilit janë ruajtur gjithë ato papiruse intrakanonike dhe esktrakanonike)

Së dyti, unë në veprat e mija kam gjykuar se kjo vepër është e pavarur nga ungjijtë intrakanonikë (1985: 35-37 = 1992: 17-19). Nëse ky ungjill do të kishte pasur varësi letrare të drejtpërdrejt, d.m.th., nëse autori i ungjillit të Thomait do të kishte pasur para vetes ungjijtë intrakanonikë gjatë kohës kur shkruante veprën e tij, do të kishte qenë e pritshme që të gjendej ndonjë ndikim nga rendi dhe përmbajtja e tyre në ungjillin e Thomait.

Përsa i përket rendit: Në vitin 1979 Bruno de Solages i vendosi thëniet e ungjillit të Thomait në një kolonë sipas rendit, dhe në një tjetër kolonë po sipas rendit vendosi ekuivalentet e tyre siç shfaqen në ungjijtë intrakanonikë dhe në burimin Q. Më pas ai vendosi linja ndërmjet versioneve ekuivalente të të njëjtës thënie. Ajo që rezultoi nga ky proces ishte një rrëmujë e plotë linjash të cilat nuk shfaqin në asnjë vend ndonjë rend të përbashkët.

Në lidhje me përmbajtjen: Në vitin 1966 John H. Sieber's mbrojti doktoraturën në Claremont Graduate School duke u fokusuar jo në materialin e përbashkët që gjendej në ungjillin e Thomait dhe në atë të Sinoptikëve, por në detajet e veçanta stilistike apo redaksionale që gjenden në ungjijtë Sinoptikë. Ai doli në përfundimin se "gjenden prova të pakta të gjurmëve redaksionale, për të mos thënë asnjë, që të na lejojnë të hamendësojmë se ungjijtë tanë Sinoptikë janë burimi i ungjillit të Thomait. Në shumicën e rasteve nuk gjendet qoftë edhe një provë e vetme" (f.262). I njëjti përfundim, i arrirë përmes një metodologjie të rreptë si kjo që përmendëm më lart, është shfaqur në një tjetër disertacion të mbrojtur në Claremont nga Stephen J. Patterson në vitin 1998. Ai doli me përfundimin se: "ndonëse ungjilli i Thomait dhe ato Sinoptikë bashkëndajnë një trupë të gjerë materialesh, gjithsesi, nuk gjendet as një model i përbashkët ndërvarësie ndërmjet një teksti dhe një tjetri dhe as njëzëshmëri në mënyrën se si çdo tekst e ka renditur materialin e përbashkët. (1993: 16).

Po nëse dikush hedh hipotezën e një varësie letrare indirekte, d.m.th. mundësia që autori i ungjillit të Thomait të ketë krijuar një përmbledhje thëniesh pasi ka dëgjuar apo lexuar ungjijtë sinoptikë, kohë më parë? Në këtë pikë theksimi, natyrisht, zhvendoset nga mungesa në ungjillin e Thomait të ndonjë rendi redaksional apo përmbajtësor të rrjedhur prej Sinoptikëve drejt qëllimit redaksional dhe të kompozimit të kryer nga Thomait. Përse ky autor zgjodhi të bënte pjesë përbërëse të tekstit të tij pikërisht ato thënie dhe jo gjithë të tjerat? Përse, për të dhënë një shembull, vendosi të dëgjonte apo lexonte vetëm

atë *grup* bekimesh që gjenden tek Mateu dhe Luka dhe i kujtoi ato në ungjillin e tij 54 (i varfër), 68-69:1 (i persekutuar) dhe 69:2 (i uritur)?

Ungjilli i Thomait është krejtësisht i veçantë ndërmjet teksteve ekstrakanonike të cilat janë propozuar si të pavarur nga ungjijtë kanonikë, kjo për arsye se ai nuk është një tekst fragmentarë por një tekst i plotë. Ai i cili nuk bindet për pavarësinë e tij karshi ungjijve kanonikë vështirë se bindet për ndonjë tekst tjetër të këtij lloji. Në vitin 1978 George MacRae doli në përfundimin se “mesa duket shumica e shkollarëve të cilat e kanë analizuar me seriozitet këtë çështje kanë anuar në krahun e atyre të cilët besojnë në pavarësinë letrare të këtij ungjilli nga ungjijtë kanonikë, ndonëse këto teologë kanë një sërë qëndrimesh të ndryshme në lidhje me historinë e përpilimit të ungjillit të Thomait” (f. 152). Sidoqoftë, në kohët tona teoria e pavarësisë letrare të ungjillit të Thomait nga ungjijtë e tjerë kanonikë është mjaftueshëm e mbështetur nga ekspertë, aq sa tani mund të fillohet të punohet me këtë teori dhe të testohet ajo me tej. Kjo është ajo që unë kam bërë në të kaluarën dhe që kam ndërmend të bëj akoma më fuqimisht në të ardhmen.

Përktheu: Rezart Beka

[*] John Dominic Crossan njihet gjerësisht si një prej shkollarëve më të mëdhenj në botë përse i përket kërkimeve për Jezusin historik. Ai është profesor emeritus për studimet fetare në “DePaul University”, Çikago. Vetëm këto tridhjet vitet e fundit ai ka shkruar rreth njëzet libra në lidhje me Jezusin historik, katër prej të cilëve janë bërë bestseller kombëtarë: *The Historical Jesus* (1991), *Jesus: A Revolutionary Biography* (1994), *Who Killed Jesus* (1995), and *The Birth of Christianity* (1998). Ai ka qenë bashkë kryetarë i Jesus Seminar dhe ish kryetarë i Historical Jesus Section of the Society of Biblical Literature, një shoqatë kjo ndërkombëtare shkollarësh për studimet biblike me qendër në Amerikë.

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi